

**SOME PREPOSITIONAL OBJECT PHRASES
(PRÄPOSITIONALOBJEKTE) IN THE GERMAN LANGUAGE AND
THEIR REALIZATION IN ALBANIAN – A CONTRASTIVE ANALYSIS**

**DISA SINTAGMA PARAFJALORE KUNDRINORE
(PRÄPOSITIONALOBJEKTE) TË GJUHËS GJERMANE DHE
REALIZIMI I TYRE NË GJUHËN SHQIPE – ANALIZË
KONTRASTIVE**

Mamure SULEJMANI¹

¹* Gymnasium „Zef Lush Marku“ – Skopje

*Corresponding author e-mail: m.sulejmani233031@unite.edu.mk

Abstract

This paper examines several prepositional object phrases in the German language (Präpositionalobjekte), focusing on their syntactic function and the manner in which they are realized and translated into Albanian, following a contrastive approach between German and Albanian. Based on the normative grammars of Duden, the definitions of the object and the use of the Dative and Accusative cases in the construction of these phrases are analyzed. Special attention is given to the semantic differences between the prepositions *auf* and *über*, which—although often translated similarly into Albanian—carry distinct shades of meaning depending on context and verb tense. Through a contrastive analysis, the paper explores the challenges posed by the translation of these constructions and identifies possible syntactic equivalents in the Albanian language.

Keywords: *prepositional object phrases, Präpositionalobjekte, German language, Albanian language, Dative, Accusative, translation, prepositions, contrastive analysis, syntactic equivalence.*

Përmbledhje

Ky punim shqyrton disa sintagma parafjalore kundrinore në gjuhën gjermane (Präpositionalobjekte), duke u përqendruar në funksionin e tyre sintaksor dhe mënyrën e realizimit dhe përkthimit në gjuhën shqipe, duke ndjekur një qasje kontrastive ndërmjet gjermanishtes dhe shqipes. Duke u mbështetur në gramatikat normative të Duden-it, analizohen përkufizimet e kundrinorit dhe përdorimi i rasave Dativ dhe Akkusativ në ndërtimin e këtyre sintagmave. Vëmendje e veçantë i kushtohet dallimeve semantike ndërmjet parafjalëve *auf* dhe *über*, të cilat, ndonëse përkthehen në mënyrë të ngjashme në shqip, bartin nuanca kuptimore të dallueshme që varen nga konteksti dhe koha e foljes. Përmes një analize kontrastive, shqyrtohen sfidat që paraqet përkthimi i këtyre konstruktëve dhe identifikohen ekuivalentët sintaksorë të mundshëm në gjuhën shqipe.

Fjalë kyçe: *sintagmat parafjalore kundrinore, Präpositionalobjekte, gjuha gjermane, gjuha shqipe, Dativ, Akkusativ, përkthim, parafjalë, analiza kontrastive, ekuivalencë sintaksore.*

Përkufizime për kundrinorin në gjuhën gjermane

Termi *kundrinor* në gramatikë është i njohur për shumë njerëz, por jo për të gjithë. Megjithatë, pak e dinë se u deshën qindra vite për të arritur në këtë emërtim. Është interesante që në gramatikën aktuale të Duden-it nuk jepet një përkufizim i përgjithshëm për kundrinorin, por ai trajtohet vetëm në lidhje me rasën përkatëse. P.sh.: *Kundrinori në dhanore është një pjesë e fjalisë e shprehur me një grup emëror në rasën dhanore*.⁴⁰ (Duden 2009: 817)

Ndërsa, në botimin e vitit 1984 mund të gjenden përshkrime më të hollësishme, si: *Kundrinorët janë gjymtyrë të fjalisë që përcaktohen në rasën e tyre drejtpërdrejt nga kallëzuesi ose – më rrallë – nga një mbiemër. Sipas formës, dallohen kundrinori në gjinore, dhanore, kallëzore dhe ai me parafjalë. Vendin e kundrinorit mund ta zë gjithmonë edhe një përemër*.⁴¹ (Duden 4 1984: 576)

Në shumicën e gramatikave bashkëkohore të gjuhës gjermane dallohen tre deri në katër lloje kundrinorësh. Përveç kundrinorit në gjinore, në dhanore dhe në kallëzore, ekziston edhe kundrinori me parafjalë si dhe sintagmat parafjalore (Glinz 1994: 215). Sa u përket grupeve parafjalore, bëhet dallimi midis një sintagme parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekt), një sintagme parafjalore kallëzuese (prädikativen Präpositionalgruppe) dhe një sintagme parafjalore rrethanore (adverbialen Präpositionalphrase). (Duden 2009: 839)

Sintagma parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekt)

Sintagma parafjalore kundrinore, në formën tipike, është një gjymtyrë e fjalisë e shprehur me një emër ose përemër të shoqëruar nga një parafjalë. Parafjala është pjesë përbërëse e kësaj gjymtyre, por zgjedhja e saj varet nga fjala prej së cilës sintagma parafjalore kundrinore varet. (Duden 4 1998: 646)

Shembuj në gjuhën gjermane:

1. Wir hoffen *auf bessere Zeiten*.
2. Sie dachte *an sein Versprechen*.

Përkthimi i tyre në gjuhën shqipe (M.S.)⁴²:

1. Ne shpresojmë *për kohë më të mira*.
2. Ajo mendoi *për premtimin e tij*.

Sintagma parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekt) në secilën fjali:

1. *auf bessere Zeiten* (*për kohë më të mira*)
2. *an sein Versprechen* (*për premtimin e tij*)

Në të dyja rastet, sintagma parafjalore kundrinore përbëhet nga një parafjalë (*auf*, *an*), ndërsa në gjuhën shqipe në të dyja rastet realizohet me parafjalën e rasës kallëzore (*për*) dhe një sintagmë emërore (*bessere Zeiten* - për kohë më të mira, *sein Versprechen* - për premtimin e tij), dhe është e varur nga folja (*hoffen*, *denken*), e cila kërkon një ndërtim të tillë me parafjalë. Te **sintagmat parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekt)**, përdorimi i parafjalës varet nga folja, ashtu siç varet rasa të llojet e tjera të kundrinave.

⁴⁰ Dativobjekt ist ein Aktant in Form einer Nominalphrase im Dativ. (Duden 4 2009: 817)

⁴¹ **Objekte sind Glieder, die in ihrem Kasus direkt durch das Prädikat oderseltener – durch ein Satzadjektiv bestimmt sind. Nach ihrer Form unterscheidet man Genitivobjekt, Dativobjekt, Akkusativobjekt und Präpositionalobjekt. Die Stelle dieses Objekts kann immer durch ein Pronomen besetzt sein.** (Duden 1984: 576)

⁴² Mamure Sulejmani, *Sintagmat parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekte) të gjuhës gjermane dhe mënyra e realizimit të tyre në gjuhën shqipe*, f. 35, (punim i magjistraturës në dorëshkrim i mbrojtur në prill, 2025, në U. e Tetovës).

Parafjalët e këtyre **sintagmave parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekt)** janë të pandryshueshme ose mund të ndryshohen vetëm në raste shumë të rralla. Vetëm disa folje marrin parafjalë të ndryshme për të njëjtën kuptim, si: sich freuen auf / über. (Pittner/Berman 2013: 38) P.sh.:

1. sich freuen auf (diçka që do të ndodhë)

Er freut sich auf den Urlaub.

Ai **gëzohet për pushimet**. (që do të vijjë)

Sie freut sich auf das Konzert.

Ajo **gëzohet për koncertin**. (që do të ndodhë)

2. sich freuen über (diçka që ka ndodhur tashmë)

Er freut sich über das Geschenk.

Ai **gëzohet për dhuratën**. (që ka marrë)

Sie freut sich über die guten Nachrichten.

Ajo **gëzohet për lajmet e mira**.

Në gjuhën gjermane, dallimi në mes parafjalëve **auf** dhe **über** qëndron në kohën e kryerjes së ngjarjes: **auf** tregon gëzim për diçka që do të ndodhë në të ardhmen, ndërsa **über** shpreh kënaqësi për diçka që tashmë ka ndodhur. Në gjuhën shqipe, të dy parafjalët (**auf** dhe **über**) realizohen me parafjalën e rasës kallëzore **për**, por kuptimi i saktë i fjalisë përcaktohet nga konteksti dhe koha e foljes. Ndryshe nga gjermanishtja, ku parafjalët janë të përcaktuara qartë, në shqip është momenti i ngjarjes i cili përcakton kuptimin. Sipas Eisenberg, parimisht mund të pranohet se në shumë raste (machen an/aus, bestehen auf/aus, ...) nuk kemi të bëjmë me një folje me parafjalë të ndryshme, por me folje të ndryshme që lidhen me një parafjalë. Kuptimi i foljes ndryshon në varësi të parafjalës së përdorur dhe veprimi në fjali nuk mund të krahasohet midis tyre. (Eisenberg 2006: 306; krahaso Anttila 1991: 72)

Gjermanishtja është një gjuhë e pasur në sistemin parafjalor dhe **sintagmat parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekte)** paraqiten vetëm në dy rasa: **Dativ** (dhanore) dhe **Akkusativ** (kallëzore). Parafjalët tipike të dhanores në gjuhën gjermane janë **mit, bei, von, zu, nach, aus, ab** etj., ndërsa ato të kallëzores janë **für, um, gegen, ohne, durch, bis** etj. Gjithashtu, ekzistojnë parafjalë që mund të përdoren si me dhanoren, ashtu edhe me kallëzoren, siç janë **in, an, unter, über, auf, vor, hinter, neben, zwischen**. Ndërsa në gjuhën shqipe, parafjalët e kallëzores, sipas kriterit sintaksor, janë: **në, me, pa, për, më, mbi** etj., ndërsa rasa dhanore nuk ka parafjalë. (Grup autorësh 1989: 285). Si rregull, një parafjalë në shqip përdoret vetëm me një rasë të caktuar, me përjashtim të parafjalëve **ndaj** dhe **për**, të cilat mund të shfaqen me dy rasa:

- **ndaj meje** (rrjedhore); **ndaj të gdhirë** (kallëzore);
- **për dore, për krahu** (rrjedhore); **për lahutë** (kallëzore).

Përkthimi dhe realizimi i sintagmave parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekte) të gjuhës gjermane në gjuhën shqipe

Në analizën tonë kemi vëzhguar që disa sintagma parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekte) ruhen në shqip me të njëjtën parafjalë, ndërsa të tjera transformohen në struktura sintaksore të ndryshme. Po japim disa shembuj në gjermanisht dhe shqip për ta sqaruar më mirë këtë dukuri morfo-sintaksore:

Shembulli 1:

Ich warte auf meinen Freund.

E pres shokun tim.

Këtu kemi **auf** + **Akkusativ** në gjuhën gjermane, ndërsa në shqip struktura përkthehet pa parafjalë.

Shembulli 2:

Er telefoniert oft mit Jitka.

Ai flet shpesh me Jitkën në telefon.

Në këtë rast, **mit** + **Dativ** është përkthyer me **me**, por në rasën kallëzore.

Foljet me parafjalë të gjuhës gjermane, si: **sorgen für, sich kümmern um, sprechen über/von, hoffen auf, fragen nach, einladen zu, sich interessieren für, warnen vor**, në gjuhën shqipe të gjitha parafjalët e mësipërme realizohen me parafjalën **për** të rasës kallëzore (Akkusativ). P.sh.:

Riza kümmert sich oft um meinen Bruder.

Riza kujdeset shpesh për vëllain tim.

Ich warne dich vor diesem Mann.

Unë të paralajmëroj për këtë njeri.

Ich interessiere mich für Geschichte.

Unë interesohem për historinë.

Edhe foljet me parafjalë të gjuhës gjermane, si: **sich fürchten vor, leiden an, schützen vor, abhängen von** etj., në gjuhën shqipe të gjitha parafjalët e mësipërme realizohen me parafjalën **prej** të rasës rrjedhore, dhe **nga** të rasës emërore. P.sh.:

Diese Jacke schützt vor dem Regen.

Kjo xhakëtë të mbron nga shiu.

Tom leidet an einer unheilbaren Krankheit.

Tomi vuan nga një sëmundje e pashërueshme / prej një sëmundjeje të pashërueshme.

Në këto raste, parafjalët gjermane **vor** dhe **an** nuk përkthehen drejtpërdrejt, por realizohen në shqip me **nga** ose **prej**, duke ia përshtatur natyrës së gjuhës shqipe, përkatësisht sistemit parafjalor të saj.

Referencat

- [1]. Anttila, H. (1991). *Zum Präpositionalobjekt und zu seiner geschichtlichen Entwicklung im Deutschen*. Wien: Universität Wien, Diplomarbeit.
- [2]. Gr. autorësh, (1989). *Gramatika e gjuhës shqipe (Morfologjia)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [3]. Berman, K. P. (2013). *Deutsche Syntax*. Tübingen: Narr Verlag.
- [4]. Çeliku, M. (2019). *Parafjalët e shqipes standarde: (trajtim leksiko-semantik e gramatikor) / Mehmet Çeliku ; red. Resul Telhaj*. Tiranë: Ilar.
- [5]. Duden 4. (1984). *Grammatik Der Deutschen Gegenwartssprache*. Mannheim-Leipzig-Wien-Zürich: Dudenverlag.
- [6]. Duden, (2009). *Grammatik Der Deutschen Gegenwartssprache*. Mannheim: Dudenverlag.
- [7]. Eisenberg, P. (2006). *Grundriss der deutschen Grammatik: Band 2: Der Satz*. Stuttgart: J. B. Metzler Verlag.
- [8]. Glinz, H. (1994). *Grammatiken im Vergleich*. Tübingen: Max Niemeyer Verlag.
- [9]. Sulejmani, M. (2025) *Sintagmat parafjalore kundrinore (Präpositionalobjekte) të gjuhës gjermane dhe mënyra e realizimit të tyre në gjuhën shqipe*, (punim i magjistraturës i mbrojtur në prill, 2025, në U. e Tetovës; në dorëshkrim; udhëheqës shkencor: Prof. dr. Arbër Çeliku).